



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1003 Prot.

Tiranë, më datë 09.11.2020

**VENDIM**

**Nr. 365, datë 06.11.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.11.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e koncept sondazhit në kuadër të projektit “Ndërtim i sistemit të K.U.B.-së (Gjimnazi “Hasan Tahsini”- Rr. “Abedin Dino”), Sarandë”, realizuar nga person i licencuar në arkeologji z. Luan Përzhita;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji për realizimin e sondazheve arkeologjike dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e sondazheve arkeologjike për projektin e “Ndërtim i sistemit të K.U.B.-së (Gjimnazi “Hasan Tahsini”- Rr. “Abedin Dino”), Sarandë” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Raporti i rezultateve të sondazheve do të kalojnë për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM-në e radhës.
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**  
**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**  
**Arta DOLLANI**